

Raportet e detajizuara në kuadër të Aplikimit për shqyrtim tarifor për sezonin ngrohës 2022/2023

Të nderuar,

N.P. "Termokos" SH.a, ka përgaditur: dokumentacionin, raportet me të dhëna dhe informatat e kërkuara nga ZRRE në kërkesën e datës 10.05.2022, në lidhje me fillimin e shqyrtimit të tarifave të energjisë termike për sezonin 2022/2023.

Përveç Paqyrave Rregullative të plotësuara me të dhëna të planifikuara, Shpalosjes së Pasqyrës B dhe Të hyrave të shtyera (të cilat ua dërgojmë si dokumente të bashkangjitura), në këtë dokument janë dhënë edhe detajizime e shpjegime përkatëse.

Bazuar në kërkesën në fjalë, në këtë dokument janë paraqitur :

1. Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qendrore të NP "Termokos" SH.A

1.1 Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogenerimi në TC Kosova B

- Në tabelën 1. është paraqitur energjia termike e planifikuar dhe kostoja e energjisë termike për sezonin 2022/23. Vlerësimi është bërë bazuar në kapacitetin e deklaruar dhe energjinë termike e cila derivon nga ky kapacitet (Kapaciteti x 6.56), ndërsa nuk është përfshirë TVSH. Në kosto është llogaritur edhe Taksa e Licencës për Energjinë Termike. Kalkulimi i koston së energjisë termike është bërë duke u bazuar në çmimin për kapacitet, energji termike dhe Taksën së Licencës për energjinë termike, të aplikuara gjatë sezonit 2021/2022.

** Planit për vitin 2023 ende nuk është aprovuar nga KOST dhe MEI

PLANIFIKIMI I ENERGJISË TERMIKE PËR SEZONIN NGROHËS 2022/2023

Sezona 2022/2023				
Muaji	Kapaciteti i deklaruar MWh/h	Energjia MWh TER	Vlera e faturës pa TVSH/€	
Tetor 2022	2.730.00	17,908.80	83,040.05	
Nëntor 2022	7.140.00	46,838.40	217,181.66	
Dhjetor 2022	8.820.00	57,859.20	268,283.23	
Janar 2023	9,967.00	65,383.52	303,172.22	
Shkurt 2023	8.068.00	52,926.08	245,409.20	
Mars 2023	7.475.00	49,036.00	227,371.56	
Prill 2023	2.729.00	17,902.24	83,009.63	
Total:	46,929.00	307,854.24	1,427,467.55	

Tabela 1. Energjia termike e planifikuar për sezonin ngrohës 2022/2023

1.2 Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në ngrohtore

- Aktualisht sasia bruto e mazutit në të katër rezervuarët është 860 ton, kurse sasia neto (të shfrytëzueshme) janë 700 ton.
- Për sezonin 2022/2023, në rast të ndonjë pengese për furnizim me energji termike nga termocentrali "Kosova B", planifikohet që furnizimi me ngrohje të bëhet nga stabilimentet e prodhimit të energjisë termike në ngrohtore.
- Për këtë qëllim janë planifikuar të shpenzohen 700 ton mazut, që mjaftojnë për furnizim në kohëzgjatje prej rreth 10 ditësh, duke shpenzuar mesatarisht nga 70 ton mazut në ditë.

Sqarim:

Meqenëse Licenca e prodhimit të energjisë termike të NQ Termokos ka skaduar në fillim të tetorit 2021, dhe në kuadër të plotësimit të kushteve për vazhdimin e kësaj licence nga ZRRE, është pajisja me Leje Mjedisore.

- Andaj me datë 27.06.2022 nga MMPHI është lëshuar vendimi për Pëlqim Mjedisor për NP"Termokos"SHA, ndërsa lidhur me kërkesën e dt. 15.10.2021, ku NQ Termokos ka kërkuar nga MMPHI lirimin nga obligimi i sigurimit të Lejes mjedisore, zyrtarët e MMPHI na kanë informuar se nuk kanë bazë ligjore për një veprim të tillë, andaj nuk mund të n'a lirojnë nga ky kusht. Prandaj jemi të obliguar që të ndjekim procedurat e parapara sipas ligjeve konkrete për t'u pajisur me Leje Mjedisore. Ndërkaq, me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leje Mjedisore të Integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI). Me këtë rast në MMPHI është dërguar



ngrohitorja e qytetit

Aplikacioni i plotësuar (me numër protokoli 1059/1 të datës 08.08.2022) dhe dokumentet mbështetëse, të kërkuara në këtë Aplikacion. Lidhur me këtë çështje, jemi në pritje të vendimeve të MMPHI për rrjedhën e këtij procesi që ka të bëjë me plotësimin e kushteve të caktuara sipas legjislacioneve në fuqi.

2. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë në sezonin 2022/2023

Në tabelën 2. është pasqyruar planifikimi për furnizimin e konsumatorëve me energji termike / ngrohje, si dhe humbjet në rrjetin e transportit (TC Kosova B-NQ Termokos), vetkonsumi dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në këtë tabelë nuk është përfshirë planifikimi i prodhimit të energjisë në ngrohore, pasi që ajo planifikohet vetëm për rastet emergjente.

PLANIFIKIMI I SASISË SË ENERGJISË DHE HUMBJEVE PËR SEZONIN 2022/2023									
Sezona 2022/2023									
Kapaciteti i deklaruar	Energjia termike	Energjia termike e pranuar nga KEK	Humbjet e energjisë në rrjetin e transportit	Konsumi vetanak	Energjia neto e futur në rrjetin e shpërndarjes	Energjia e liferuar te konsumatorët	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes	%
MWh/h	MWh TER	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	%
Tetor 2022	2,730.00	17,908.80	17,550.62	60.00	17,490.62	16,091.37	1,399.25	1,399.25	
Nëntor 2022	7,140.00	46,838.40	45,901.63	55.00	45,846.63	42,178.90	3,667.73	3,667.73	
Dhjetor 2022	8,820.00	57,859.20	56,702.02	85.00	56,617.02	52,087.65	4,529.36	4,529.36	
Janar 2023	9,967.00	65,383.52	64,075.85	140.00	63,935.85	58,820.98	5,114.87	5,114.87	
Shkurt 2023	8,068.00	52,926.08	51,867.56	125.00	51,742.56	47,603.15	4,139.40	4,139.40	
Mars 2023	7,475.00	49,036.00	48,055.28	130.00	47,925.28	44,091.26	3,834.02	3,834.02	
Prill 2023	2,729.00	17,902.24	17,544.20	75.00	17,469.20	16,071.66	1,397.54	1,397.54	
Total :	46,929.00	307,854.24	301,697.16	670.00	301,027.16	276,944.98	24,082.17	24,082.17	8.0

Tabela2. Planifikimi i energjisë termike dhe humbeve në rrjetin e transportit të energjisë dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

- Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë është planifikuar të jenë 2%, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8%.

Sqarim :



Humbjet e energjisë (ujit) në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8%, pjesa më e madhe e këtyre humbjeve i referohet mbushjeve me ujë të trajtuar të rrjetit sekondar në objektet e reja dhe në objektet e vjetra, aty ku janë duke u instaluar nënstationet e reja.

Me projektin e KfW do të kryen 141 objekte – nënstatione vetëm në lagjen Mati 1, gjithashtu edhe shumë objekte të tjera në kuadër të zgjerimit dhe dendësisimit të rrjetit, rrjeti sekondar i të cilave mbushet vetëm nga rrjeti primarë. Gjithashtu ndikim të madh kanë edhe rrjedhjet në segmente të caktuara të rrjetit, të cilat ende nuk janë rehabilituar. Andaj, elementet që ndikojnë në këtë nivel të parashikimit të humbjeve të energjisë (ujit) janë:

- Segmentet e vjetëruara të rrjetit të shpërndarjes,
- Zgjerimi i rrjetit primarë,
- Testimet hidraulike,
- Pjesa sekondare e objekteve të reja dhe atyre ku janë ndëruar nënstationet do të mbushet me ujë nga rrjeti primarë.

3. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve

Në tabelën 3, kemi paraqitur të dhënat aktuale për: numrin e konsumatorëve, sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin termik.

Numri aktual i konsumatorëve			
	Numri i konsumatorëve	Sipërfaqja /m ²	Kapaciteti termik /MW
Sektor i Banesor	14,249	856,366.60	85.64
Sektor i Biznesor	1,290	94,104.27	13.17
Sektor i Institucional	252	502,585.19	70.36
TOTAL	15,791	1,453,056.06	169.17

Tabela 3. Numri aktual i konsumatorëve, sipërfaqet respektive dhe kapaciteti termik

4. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2022/2023

Në vijim, në mënyrë tabelare kemi paraqitur të përmbledhura, të dhënat për sipërfaqen, konsumin vjetor të energjisë dhe konsumin specifik vjetor, në varësi të llojit të konsumatorëve për sezonin e kaluar 2021/2022 dhe planifikimin për sezonin 2022/2023.

Planifikimi - Sezona 2022/2023			
	Sipërfaqja/ m ²	Konsumi vjetor i energjisë/MWh	Konsumi specifik KWh/m ² /vit
Konsumatorët shtëplak	959,975.86	164,158.72	171
Konsumatorët Komercial dhe Institucional	609,965.60	112,782.64	184.9
Total	1,569,941.46	276,941.36	177.95

Tabela 5. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2022/2023

5. Planifikimi i kycjeve të reja gjatë sezonit 2022/2023

Lidhur me planifikimin e kycjeve të reja , në Tabelën 6, janë paraqitur detaje për planifikimin e kycjeve të reja gjatë periudhës në fjalë, duke përfshirë lokacionin, numrin e konsumatorëve dhe sipërfaqet ngrohëse .

Objektet e paraqitura në këtë tabelë , janë planifikuar të kycen gjatë sezonës ngrohëse 2022/2023, bazuar në realizimin e Projektit të KfW për zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes.

PLANIFIKIMI I KYÇJEVE TË REJA GJATË SEZONIT NGROHËS 2022/2023								
Nr.rend	Kodi i objektit	Adresa	Nr.i batesave	Nr.i lokaleve	Gjithësej	Slp.banesore m²	Slp.fariste m²	Gjithësej m²
1	UL-2	Rr.Selami Pulaha	9	1	10	567.00	63.00	630.00
2	UL-4	Rr.Selami Pulaha	9	1	10	567.00	63.00	630.00
3	UL-7	Rr.Selami Pulaha	9	1	10	567.00	63.00	630.00
4	UL-12	Bul. Dëshmorët e Kombit	17	2	19	1,096.20	121.80	1,218.00
5	UL-28	Rr.Zijah Shemsiu	102	11	113	6,615.00	735.00	7,350.00
6	QP-1	Rr.Garibaldi	26	3	29	1,698.30	188.70	1,887.00
7	QP-6	Rr.Garibaldi	14	2	15	882.00	98.00	980.00
8	QP-11	Rr.Garibaldi	10	1	11	667.80	74.20	742.00
9	QP-12	Rr.Garibaldi	7	1	8	453.60	50.40	504.00
10	QP-13	Rr.Garibaldi	7	1	8	453.60	50.40	504.00
11	CE-2	Rr.Agim Ramadani	8	1	8	491.40	54.60	546.00
12	CE-9	Rr.Sylejman Vokshi	6	1	6	378.00	42.00	420.00
13	CE-12	Rr.Nëna Terezë	12	1	13	787.50	87.50	875.00
14	CE-13	Sheshi Zahir Pajaziti	17	2	19	1,134.00	126.00	1,260.00
15	CE-16	Sheshi Zahir Pajaziti	42	5	47	2,734.20	303.80	3,038.00
16	CE-25	Bul.Nënë Tereza	7	1	8	466.20	51.80	518.00
17	CE-26	Rr.Sylejman Vokshi	8	1	9	504.00	56.00	560.00
18	DAE-2	Bul. Dëshmorët e Kombit	5	1	5	302.40	33.60	336.00

19	DAE-9		21	2	24	1,386.00	154.00	1,540.00
20	DAW-1	Rr. Lekë Dukagjini	13	1	14	827.10	91.90	919.00
21	DAW-1	Rr. Lekë Dukagjini	17	2	19	1,096.20	121.80	1,218.00
22	ZD- (2,3,4,5,6)	Rr. Gazmend Zajmi	240	27	267	15,611.40	1,734.60	17,346.00
23	MS-1	Rr. Uran Ajët	124	14	138	8,080.20	897.80	8,978.00
24	MS-2	Rr. Teodor Muzaka	52	6	58	3,402.00	378.00	3,780.00
25	MS-3	Rr. Teodor Muzaka	37	4	41	2,425.50	269.50	2,695.00
26	MS-11	Rr. Uran Ajët	41	5	45	2,646.00	294.00	2,940.00
27	MS-22	Rr. Muharrem Fejza	63	7	70	4,095.00	455.00	4,550.00
28	MS-34	Rr. Ukshin Kovaqica	23	3	26	1,512.00	168.00	1,680.00
29	MS-39	Rr. Qarnië Panariti	48	5	54	3,131.10	347.90	3,479.00
30	MS-42	Rr. Ahmet Gashi	37	4	41	2,425.50	269.50	2,695.00
31	MS-43	Rr. Malush Kosova	29	3	32	1,890.00	210.00	2,100.00
32	MS-45	Rr. Muhamet Çami	79	9	87	5,103.00	567.00	5,670.00
33	MS-46	Rr. Muhamet Çami	39	4	44	2,551.50	283.50	2,835.00
34	MS-48	Rr. Ahmet Gashi	47	5	53	3,087.00	343.00	3,430.00
35	MS-51	Rr. Muhamet Çami	54	6	60	3,528.00	392.00	3,920.00
36	MS-52	Rr. Prekazi	43	5	48	2,822.40	313.60	3,136.00
37	MS-54	Rr. Prekazi	35	4	39	2,268.00	252.00	2,520.00
38	MS-55	Rr. Prekazi	66	7	73	4,258.80	473.20	4,732.00
39	MS-56	Rr. Prekazi	101	11	113	6,597.00	733.00	7,330.00
40	MS-57	Kerem Lewton	35	4	39	2,268.00	252.00	2,520.00
41	MS-58	Rr. Lotë Vaku	53	6	59	3,424.50	380.50	3,805.00

42	MS-59		60	7	67	3,931.20	436.80	4,368.00
43	MS-61	Rr. Beqir Kastrati	144	16	160	9,355.50	1,039.50	10,395.00
44	MS-63	Rr. Beqir Kastrati	23	3	26	1,512.00	168.00	1,680.00
45	MS-71	Rr. Muharrem Fejza	74	8	82	4,788.00	532.00	5,320.00
46	MS-74	Rr. Muharrem Fejza	38	4	42	2,457.00	273.00	2,730.00
47	MS-78	Rr. Fazli Gashi	60	7	66	3,884.40	431.60	4,316.00
48	MS-79	Rr. Fazli Gashi	37	4	41	2,381.40	264.60	2,646.00
49	MS-80	Rr. Fazli Gashi	46	5	51	2,998.80	333.20	3,332.00
50	MS-81	Rr. Fazli Gashi	-	1	1	2,940.00	2,940.00	2,940.00
51	MS-99	Rr. Ahmet Korenica	57	6	63	3,672.90	408.10	4,081.00
52	MS-100	Rr. Ahmet Korenica	31	3	35	2,028.60	225.40	2,254.00
53	MS-101	Rr. Ukshin Kovaçica	24	3	27	1,587.60	176.40	1,764.00
54	MS-102	Rr. Ukshin Kovaçica	22	2	24	1,405.80	156.20	1,562.00
55	MS-103	Rr. Nezir Mujaj	26	3	29	1,701.00	189.00	1,890.00
56	MS-104	Rr. Skender Çeku	87	10	97	5,670.00	630.00	6,300.00
57	MS-105	Rr. Skender Çeku	106	12	117	6,860.70	762.30	7,623.00
58	MS-111	Rr. Bardhyl Çaushti	62	7	69	4,032.00	448.00	4,480.00
59	MS-118	Rr. Ukshin Kovaçica	40	4	44	2,580.30	286.70	2,867.00
60	MS-120	Rr. Beqir Kastrati	22	2	25	1,451.70	161.30	1,613.00
61	MS-129	Rr. Prekazi	39	4	43	2,520.00	280.00	2,800.00
62	MS-134	Rr. Muhamet Çami	47	5	52	3,061.80	340.20	3,402.00
GIITHSEJ:			2,657	296	2,953	172,682.10	22,126.90	194,809.00

Tabela 6. Planifikimi i kqjveve të reja gjatë sezonit 2022/2023

6. Planifikimi i Investimeve me vetfinansim

6.1. Projekti për "Ndërtimin e Objektivit të ri Administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse"

Në kuadër të këtij projekti, janë zhvilluar procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e kontraktorit për:

1. "Mbikqyrja e ndërtimit të objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse"
2. "Ndërtimi i objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse"

Sqarim:

1. Procedura e prokurimit për zgjedhjen e kontraktorit për "Mbikqyrjen e ndërtimit të objektit të ri administrative dhe objekteve përcjellëse" - ka filluar me datë 11.09.2020, mirëpo për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik në O.S.H.P. dhe në mungesë të Bordit të OSHP, nuk ka qenë e mundur zgjedhja e operatorit për kryerjen e këtij shërbimi. Meqenëse së fundmi Bordi i OSHP është zgjedhur, planifikojmë që në periudhën raportuese të zgjidhet operatori për mbikqyrje të objektit. Vlera e mjeteve të alokuara për këtë projekt është 120,000.00 euro. Për këtë periudhë raportimi kemi planifikuar vlerën prej 60 000 euro për mbikqyrjen e ndërtimit të objektit.

2. Procedura e prokurimit për zgjedhjen e kontraktorit për "Ndërtimin e Objektivit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse" - ka filluar me datë 06.01.2021, mirëpo për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik në OSHP dhe në mungesë të Bordit të OSHP, nuk ka qenë e mundur zgjedhja e operatorit për ndërtimin e objektit. Meqenëse së fundmi Bordi i OSHP është zgjedhur, planifikojmë që në periudhën raportuese të zgjidhet operatori për ndërtimin e objektit dhe të fillojë ndërtimi i objektit.

Vlera e mjeteve të alokuara për këtë projekt është 2,200,000.00 euro. Për këtë periudhë raportimi kemi planifikuar vlerën prej 1 milion euro për ndërtimin e objektit.

6.2. Investimi për "Furnizim me Valvola DN -500 dhe DN-600"

Udhur me projektin për "Furnizim me Valvola DN -500 dhe DN-600", për të cilën aktiviteti i prokurimit është zhvilluar në vitin 2019, është anuluar pasi të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme dhe është ritenderuar në vitin 2020. Aktualisht, ky aktiviteti i prokurimit është i pezulluar për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik tek OSHP. Meqenëse Bordi i OSHP është formuar së fundmi, presim së shpejti një përgjigje për statusin e këtij investimenti.



ngrohitorja e qytetit

Për realizimin e këtij investimi, gjatë periudhës raportuese, kemi planifikuar vlerën prej **120,000 euro**.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detaje për investimet- projektet, që planifikohet të realizohen me mjete vetanake të N.P"Termokos"SH.A, gjatë periudhës tetor 2022/tetor 2023.

6.3. Bashkëfinancimi për Projektin me KfW/Programi I Energjis VIII dhe IX

Si bashkëfinancues për Projektin me KfW/Programi I Energjis VIII dhe IX, NP "Termokos "SH.A, gjatë vitit 2023 do të paguaj minimum 2 milion euro. Kjo e dhënë është paraqitur në tabelën 7.

6.4. Bashkëfinancimi për Projektin për dyfishim të kapaciteteve termike në 280MW

Si bashkëfinancues për projektin për dyfishim të kapaciteteve termike në 280 MW, NP "Termokos "SH.A , gjatë vitit 2023 do të paguaj 0.5milion euro. Kjo e dhënë është paraqitur në tabelën 7.

Investimet me mjete vetanake të Termokosit (tetor 2022- tetor 2023)			
Distribubim			
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2022)/ €		Periudha (janar -tetor 2023)/€
Gypa të paraizoluar	50,000.00		
Këmbyes			15,000.00
Pompa qarkulluese	30,000.00		
Valvola dhe Filtra	30,000.00		15,000.00
Valvola rregulluese dhe matës energjie			10,000.00
Ndërtim i pusetave dhe riparimi i rrugëve	10,000.00		15,500.00
Furnizim me automjete			25,000.00
Total	120,000.00		80,500.00
Total Distribubim : 200,500.00euro			

Prodhimi		
Përkirimi	Periudha (tetor - dhjetor 2022)/ €	Periudha (janar - tetor 2023)/ €
Furnizim me diktuna për këmbes 50 MW		100,000.00
Këmbes të njetësish për stacionin B. Diellit 11000kW		25,000.00
Pjesë rezervë për pompa	30,000.00	60,000.00
Furnizimi dhe shërbimet e demontimit dhe montimit nga ekipi i specializuar për Pompa të Kogjenerimit	30,000.00	50,000.00
Regullator frekuentor për pompa për mbajtje të presionit për rrjein e shpërndarjes	12,000.00	
Servisim i valvolave për kogjenerim		50,000.00
Furnizim me Valvola DN -500, DN-600		125,000.00
Furnizim me pompë të kondenzatit	30,000.00	60,000.00
Riparim i pjesshëm i kaldajave K1 dhe K2	500,000.00	250,000.00
Furnizim me pjesë rezervë për stacionet HRS dhe HES		50,000.00
Furnizim - valvola siguruese	9,500.00	5,000.00
Furnizim me valvola rregulluese me matës të energjisë	15,000.00	
Klaibrimi i matësve të energjisë në stacionin HRS dhe HES		15,000.00
Servisimi i autorizuar i servomotorve të valvolave në stacionin HRS dhe HES		12,000.00
Servisim i autorizuar i pompave të kogjenerimit		50,000.00
Riranimi i gypave të Laguna	120,000.00	
Total:	746,500.00	852,000.00
Total Prodhimi : 1,598,500 euro		
Administrata		
Përkirimi	Periudha (tetor - dhjetor 2021)/ €	Periudha (janar - tetor 2022)/ €
Ndërtimit të objektit Administrativ		1,000,000.00



Mbikqyrja e ndërtimit të objektit Administrativ

Furnizimi me Kompiuter, Laptop dhe printera, ploter .

Blerja e licenceve të Sistemit Operativ dhe Microsoft Office për të gjithë përdoruesit e PC.

Total Administrata : 1,190,000 euro

60,000.00

30,000.00

100,000.00

Investimi - Bashkëfinancimi për Projektet zhvillimore

Përshkrimi

Bashkëfinancimi për Projektin e Komisionit European /Dyfishimi i Kapaciteteve për Prodhimin e Energjisë Termike

Periudha (tetor - dhjetor 2021)/ €

Periudha (janar -tetor 2022)/€

500,000.00

Bashkëfinancimi për Projektin me KfW/Programi I Energjisë VIII dhe IX

2,500,000.00

Total Bashkëfinancim: 3,000,000.00 euro

Total Investimet vetanake: 5,989,000.00 euro

Tabela 7. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim

7. Planifikimi i Investimeve nga Donacionet gjatë periudhës (tetor 2022-tetor 2023)

Në investimet nga donacionet janë përfshirë katër projekte :

- 1.Projektit "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore në qytetin e Prishtinës" i financuar nga KfW,
- 2.Projekti për instalimin e matësve të energjisë – MCC,
3. Projekti "Solar4Kosova ",
- 4.Projekti për dyfishim të kapaciteteve termike në 280MW.

Z.1. Projektit "Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore në qytetin e Prishtinës" i financuar nga KfW

Informacione të përgjithshme

Projekti për Zgjerim dhe Rehabilitim të Rrjetit të Ngrohjes Qendrore, do të financohet si donacion nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Qeveria e Luksemburgut si dhe në bashkëfinancim me NP "Termokos" sh.a. Ky projekt planifikohet të realizohet në periudhën 2019-2022.

Vlera e këtij projekti planifikohet të jetë rreth 16 milion euro.

Si donacion janë dhënë 12.3 milion euro nga:

- Qeveria Gjermane përmes KfW – 10 milion euro,
- Qeveria e Luksemburgut – 2.3 milion euro
- Ndërsa, pjesa tjetër do të mbulohet nga NP "Termokos" sh.a.

Ky projekt është i ndarë në dy lloje (kontrata) T-1 dhe T-2:

a) Kontrata T-1, MZ ID 201667575 / Procurement No. 505734 Supply and Installation of Heat Storage, Thermal Substations, Chemical Water Treatment and SCADA

Kontraktor: JV Brunata & ERGOTEM

Vlera e kontratës: 7,784,573.17 EURO

Të paguara - Pagesa fillestare/avansi : 1,556,914.63 €

Me këtë kontratë është planifikuar ndërtimi i 333 nënstacioneve të reja në pjesën që i përket zgjerimit të rrjetit, dhe rehabilitimi i 235 nënstacioneve ekzistuese.

Pjesë e projektit është edhe ndërtimi i rezervuarëve të nxehtësisë me kapacitete 2x400m³, integrimi i këtij sistemi në SCADA si dhe rehabilitimi i sistemit për mbajtje të shtypjes në rrjetin shpërndarës. Kontrata për këtë pako tenderuese është nënshkruar në fund të dhjetorit 2021.

Për periudhën raportuese (tetor 2022- tetor 2023) për T-1, planifikohet të realizohet vlera prej 4,359,360.978 euro,

b) Kontrata T-2, Project: "Improvement of District Heating System Pristina", Contract 2 - supply and installation of DH pipes, BMZ ID 201667575

Kontraktor : ALL ZONE LLC

Vlera e kontratës: 4,349,630.52 €;

Punë shtesë (V01): 1,168,184.08 €;



ngrohtorja e qytetit

Kosto, shtesë/Ankesë e aprovuar: 874,595.75 €;

Vlera Totale e projektit: 6,392,410.35 €;

Të paguara: 3,369,700.71 €;

Në këtë kontratë përfshihet instalimi i rrjetit në pjesët e qytetit ku planifikohet zgjerim dhe densifikim i rrjetit të ngrohjes qëndrore, si dhe rehabilitim i segmenteve të caktuara të rrjetit ekzistues.

Kontrata me kontraktorin ALL ZONE është nënshkruar në fund të dhjetorit të vitit 2020, ndërsa punimet konkrete në teren kanë filluar në fillim të majit të vitit 2021.

Për periudhën raportuese (tetor 2022- tetor 2023) për T-2, planifikohet të realizohet vlera prej 3,022,709.64 euro.

Vlera e totale për dy paket e projektit (T-1 dhe T-2) që planifikohet të realizohet për periudhën (tetor 2022-tetor 2023), është 7,382,071.00 euro.

Sqarim:

Sipas kontratave të reviduara me punë shtesë të projektit të KfW, pjesa prej 7.3 milion euro, do të paguhet nga NP "Termokos" sh.a gjatë periudhës (2021- 2024), si bashkëfinancues i këtij projekti.

Ky bashkëfinancim është dedikuar për mbulimin e zgjerimit të rrjetit jashtë kontratës, në lagjen Mati 1 ka pasur 32 ndërtime të objekteve të reja në krahasim me kohën kur është bërë projekti fillestarë.

Në kuadër të kësaj, nga Termokosi në vitin 2021 është paguar shuma prej 400,000.00 eurosh dhe për vitin 2022 janë ndarë 1milion euro (nga të cilat 750,000.00 euro janë paguar dhe së shpejti do të paguhet edhe 250,000.00euro). Prandaj, shuma e mbetur prej 5.9milion euro do të mbulohet nga Termokosi gjatë periudhës 2023-2024, dhe gjatë vitit 2023 planifikohet të paguhet shuma prej 2,500,000.00 eurosh (e paraqitur në tabelën 7).

7.2 Planifikimi i Investimeve financuar nga (Qeveria Amerikane - MCC) për periudhën (tetor 2021- tetor 2022)

Projekti për instalimin e matësve të energjisë - MCC

1. Projekti i matësve të energjisë :

Supply, Installation, Maintenance of relevant equipment and services for the introduction of consumption based heat metering and thermostatic heating valves in District Heating, Prishtina

Kontrata për këtë projekt është nënshkruar në Prill 2022, në mes të MFK (Millenium Foundation-Kosova) dhe kontraktorit "ENERCO LLC" Sh.P.K – Prishtinë.

Deri në fund të muajit qershor, kompanija kontraktuese ka bërë hulumtime dhe matje në banesa të cilat janë pjesë e projektit. Janë bërë projekte dhe kalkulime hoidraulike për vlerësimin e nevojave për dizajnim dhe zgjedhje të pajisjeve adekuate për tu instaluar (valvola për radiator, valvole balancuese, pompave qarkulluese etj).

Deri më tani kontraktori ka bërë furnizime të konsiderueshme me material dhe pajisje për realizimin e projektit. Instalimi i matësve të energjisë pritet të filloj në javen e tretë të muajit Korrik 2022.

Vlera që planifikohet të realizohet për periudhën raportuese (tetor 2022-tetor 2023), është 6,905,850.00euro.

1. Projekti "Solar4Kosova"

Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore "Solar4Kosova" është në fazën finale të studimit të fizibilitetit. Projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social), i punuar nga CES-IC dhe financuar nga KfW, është në fazën përfundimtare.

Është definuar dhe aprovuar lokacioni prej 25 ha tokë për këtë projekt. Lokacioni është në zonën Hade e Re.

Ka filluar procedura për parakualifikim për përzgjedhjen e kompanisë konsulente për projekt. Kjo procedurë planifikohet të përfundojë deri në fund të vitit 2022. Nëse çdo gjë shkon sipas planifikimit, fazat e para të projektit pritet të fillojnë në muajt e parë të vitit 2023.

Për periudhën raportuese (tetor 2022- tetor 2023) për projektin Solar4 Kosova, planifikohet të realizohet vlera prej 5million euro, të dedikuara për punë përgaditore dhe projekte.

2. Projekti për dyfishim të kapaciteteve termike në 280MW

Me 17.06.2022 është nënshkruar marrëveshja në mes të Bankës Europiane për Investime (EIB) dhe Termokosit, për projektin për dyfishim të kapaciteteve të energjisë termike të ekstraktuar nga TC" Kosova B", BEI ka nda një grant në vlerë prej 1,500,000.00 euro për financimin e studimeve paraprake për këtë projekt.

Për periudhën raportuese (tetor 2022- tetor 2023) për këtë projekt, planifikohet të realizohet vlera prej 1.5million euro, për studime paraprake.

Në tabelën në vijim ju paraqesim të përmbledhura investimet nga donacionet e paraqitura më lartë.

Planifikimi i Investimeve nga donacionet për periudhën (tetor 2022- tetor 2023)					
Donatori	Projekti	Periudha (tetor - dhjetor 2022)/ €	Periudha (janar -tetor 2023)/€	Total (tetor 2022- tetor 2023) /€	
1	Qeveria Gjermane përmes KfW dhe Qeveria e Luksemburgut	T-1: Modernizimi dhe zgjerimi i sistemit të NQ me termocentrale të reja	1,245,532.00	3,113,829.00	4,359,361.00
		T-2 Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të tubacioneve	604,542.00	2,418,168.00	3,022,710.00
2	Qeveria Amerikane - MCC	Instalimi i matësve të energjisë termike	3,452,925.00	3,452,925.00	6,905,850.00
3	Aktualisht është Banka Gjermane - KfW dhe pjesëmarrje nga N.P "Termokos" sh.a.	"Solar 4 Kosova "		5,000,000.00	5,000,000.00
4	Bankës Europiane për Investime (EIB)	Dyfishim të kapaciteteve termike	500,000.00	1,000,000.00	1,500,000.00
Total investimet nga donacionet : 20,787,921.00 euro					

Tabela 8. Përmbledhje e Investimeve të planifikuara nga donacionet